

131	13.04.2021	Informacion mbi Provimin e ADR	14.04.2021	<p>Aplikantet të cilët paraqiten në trajnim për pajisje me DAP ju dërgohen me email programi i miratuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise si dhe data e testit, ndërsa njoftimi për trajnim dhe riprovim kryhet nëpërmjet telefonit zyrtar të DPSHTRR.</p>	E plote	Nuk ka
132	05.05.2021	Kërkesë per informacion-Reduktim takses vjetore per persoant PAK		<p>Në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Udhëzimit të MF nr 26, datë 4.09.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, përjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura: “Autoveturat tip deri në 4+1 vende dhe me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse, dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private”.</p> <p>Për invalidët e punës, personat e verbër, të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe personat me aftësi të kufizuar, për përjashtimin nga TVMP-ja, për çdo vit përjashtimi bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të qytetarit me status “invalid” dhe duhet që:</p> <p>i. Dosja e mjetit e qytetarit me status “invalid” dhe dosja e invaliditetit e tij duhet të jenë nën juridiksionin territorial të drejtorisë rajonale ku ka vendbanimin qytetari me status “invalid” sipas regjistrit të gjendjes civile.</p> <p>ii. Të jetë i pajisur me librezën e invaliditetit, lëshuar nga Shoqata e Invalidëve, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar, ose librezën e verbërisë, ose librezën e paraplegjikut/tetraplegjikut lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, pasi verifikohet vlefshmëria e tyre fotokopjohet dhe mbahet nga strukturat e DPSHTRR-së.</p> <p>iii. Vërtetim të KMCAPI-t, i siguar nga vetë qytetari me status “invalid”, nëpërmjet portalit ealbania, kjo në zbatim të VKM-së nr. 495, date 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike” ose vërtetimin origjinal të KMCAPI-t ose i noterizuar, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për periudhën përkatëse të invaliditetit ose kopje e vendimin të Komisionit të Përcaktimit të Verbërisë lëshuar nga Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë KMCAPI-t për personat e verbër pasi verifikohet origjinali.</p> <p>iv. Vërtetimin, e siguar nga vetë qytetari me</p>	E plote	Nuk ka

				<p>status "invalid", nëpërmjet portalit e-albania, në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 13.9.2017 "Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike", që nuk zhvillon aktivitet privat.</p> <p>v. Kartën e identitetit të vlefshme të personit me status "invalid" që ka në pronësi mjetin."</p> <p>Si rrjedhojë, Ju duhet të dorëzoni cdo vit, dokumentat e sipërcituara në momentin e përfundimit të vlefshmërisë së taksës për mjetin që posedoni.</p> <p>Në portalin qeveritar e-albania, ju shfaqet vlera e plotë e taksës pasi përjashtimi nga pagesa e taksës nuk bëhet në mënyrë automatike por bëhet pranë zyrave të taksave të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor nëpërmjet sistemit informatik edpshttr, pasi ju të dorëzoni dokumentat e sipërcituara.</p>		
133	07.05.2021	Kërkesë për informacion- Kur fillon Kontrolli teknik.	10.05.2021	<p>DPSHTRR ju bën me dije se Kontrolli Teknik i Automjeteve rifillon këto ditë pas miratimit të propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor nga Parlamenti si me poshte:</p> <p>- Përputhja me Direktivën e BE për afatet e Kontrollit Teknik (Kolaudimi): çdo dy vjet për mjetet me km; çdo 1 vit mjetet taksë, autoshkolla, transport udhëtarësh; pas tre viteve nga regjistrimi i parë në Shqipëri për mjetet e reja. Heqja e vulës nga leja. (Hyrja në fuqi pas botimit në fletroren zyrtare)</p> <p>Nëse afati ju përfundon tani, ju mund të paraqiteni pranë sporteve për të marrë një vulë në dokumentet tuaja, me të cilën ju mund të qarkulloni deri në miratimin e shërbimit.</p> <p>Taksat vjetore të mjeteve duhet të paguhet rregullisht në afatet ekzistuese, pranë Drejtorive Rajonale e nënzyrave të DPSHTRR ose përmes e-Albania online.</p> <p>Per me shume ju mund te informoheni ne kohe reale ne faqen tone zyrtare: https://www.dpshttr.al/</p>	E plote	Nuk ka
134	18.05.2021	Kërkesë për informacion- CKP e anuluar	23.05.2021	<p>Ju bëjmë me dije se nuk është DPSHTRR që përcakton se cilët punonjës kanë konflikt interesi (si në rastin tuaj) por ligji. Në lidhje me tërheqjen nga kursi duhet të bëni një kërkesë zyrtare për kthimin e dosjes dhe pagesës .</p> <p>Në bazë të Udhëzimit të përbashkët të dy ministrave 3351, datë 02.06.2009 për përcaktimin e tarfiave për pajisjen me Certifikatën e Komptences Profesionale të</p>	E plote	Nuk ka

				Drejtesit të Operatorit të Transportit Rrugor nën 8, thuhet se në rast të mospjesmarrjes të kandidatit në kursin e trajnimit ose në provim, i kthehet 70% e shumës së paguar.		
135	20.05.2021	Kërkesë për informacion- Cfarë duhet të bëj për rinovimin e patentës Greke	20.05.2021	Paraqitja pranë zyrave greke për mbarimin e procedurave të konvertimit.	E plote	Nuk ka
136	27.05.2021	Informacion mbi pronësin e mjetit me targë AA XXX YY	27.05.2021	Konstatohet se objekti i kërimit tuaj lidhet me disponimin e një informacioni që nuk është publik dhe që nuk mund të disponohet pasi përfshihet në një nga rastet përjashtimore të nenit 17 të ligjit nr.119/2014. Objekti i kërkesës suaj lidhet me përpunimin e të dhënave personale dhe në vështrim të ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ky përpunim bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.	E plote	Nuk ka
137	31.05.2021	Informacion- Mbi vendimin që është marr nga institucioni juaj për pezullimin e patentave për tejkalim të orës policore	31.05.2021	Jashtë kompetencave të DSPHTRR - Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk ka në kompetencë të saj bllokimin e patentave, por procedurën e marrjes së saj. Lutem ti drejtoheni institucionit përkatës.	E plote	Nuk ka